



Nr 500 Prot

Nr 276/14 Prot

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

KOMISIONIERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
Përfaqësuar nga Komisionieri, **Z. Robert GAJDA**

DHE

**ORGANIZATËS JO-FITIMPRURËSE “SHËRBIMI LIGJOR FALAS
TIRANË (TLAS)”**

Përfaqësuar nga Drejtore Ekzekutive e Shoqatës, **Znj. Raimonda Bozo**, regjistruar me Vendim nr 346, dt 18.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me adresë në, Tiranë,

Tiranë, MARS 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe organizata “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)”, ”, më poshtë të quajtura “palë”,

Referuar eksperiencës dhe përvojësë gjatë në garantimin e zbatimit dhe realizimit të misioneve të përbashkëta në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Nisur nga dëshira për të vendosur lidhje institucionale bashkëpunimi në interes të të dyja palëve, me qëllim promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, cuarjen përpara të bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet tyre në realizimin e veprimtarisë në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqinë këtë fushë, bien dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje, për sa më poshtë:

Neni 1 OBJEKTI

Kjo marrëveshje ka për objekt institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e rregullave dhe mënyrave brenda të cilave Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe organizata TLAS do të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre të bashkëpunimit të ndërsjelltë, në kuadër të punës së përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm si dhe interesat e ligjshme të qytetarëve shqiptarë.

Neni 2 QËLLIMI

Realizimi i veprimtarisë së përbashkët dhe të koordinuar për respektimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë, të të drejtave që lidhen me mbrojtjen e grupeve të marginalizuara; rritja e bashkëpunimit në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi, të transparencës dhe të llogaridhënies; të miratimit të politikave të reja dhe të garantimit dhe rritjes së cilësisë së shërbimit publik ndaj grupeve të marginalizuara; për të parandaluar dhe ndaluar rastet e veprimtarisë së paligjshme të institucioneve publike, si dhe për të kërkuar ndërhyrjen pozitive të institucioneve shtetërore sa herë që është e nevojshme.

Neni 3 FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo Marrëveshje do të konsistojë në:
 - a) Ndërmarrjen e nismave të përbashkëta për propozime në kuadër të përmirësimit dhe ndryshimit të legjislacionit me fokus çështjet e mbrojtjes së grupeve të marginalizuara, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventat e ratifikuara nga shteti Shqiptar.

- b) Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese në nivel kombëtar, përfshirë edhe organizimin e fushatave të përbashkëta për ndërgjegjësimin e shtetasve, të sesioneve informuese, takimeve për shkëmbimin e eksperiencave reciproke me grupet e synuara dhe publikun në tërësi, etj., në funksion të mbrojtjes më mirë të të drejtave themelore të njeriut në fushën e mësipërme.
- c) Realizimin e misioneve të përbashkëta të monitorimit në institucionet e administratës publike ku ofrohet shërbim për grupet e marginalizuara, me qëllim konstatimin e respektimit të të drejtave të njeriut apo të legjislacionit në fuqi.
- d) Referimin e rasteve konkrete, sipas nevojave të shtetasve, përfshirë edhe referimin e ndërsjellë të rasteve midis palëve në këtë Marrëveshje, kur një gjë e tillë është e lejuar nga legjislacioni në fuqi.
- e) Ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta për adresimin, referimin dhe zgjidhjen e rasteve konkrete pranë institucioneve kompetente shtetërore, administrative apo gjyqësore, vendase apo ndërkombëtare.
- f) Angazhimin e palëve në këtë Marrëveshje, për të informuar dhe rekomanduar mbi çështjet, problematikat dhe konkluzionet e konstatuara nga monitorimet apo verifikimet e kryera në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe që kërkojnë ekspertizë të veçantë.
- g) krijimin e një bashkëpunimi të frytshëm, nëpërmjet shkëmbimit të rregullt të informacionit, si nëpërmjet komunikimit të dokumenteve zyrtare, ashtu edhe nëpërmjet organizimit të takimeve periodike, për raste të ndryshme që kanë nevojë për ndërhyrje dhe mbështetje, me qëllim rivendosjen e të drejtave ligjore të shkelura të njeriut.

Neni 4

KOMUNIKIMI NDËRMJET PALËVE

- 4.1. Palët angazhohen të mblidhen në mënyrë periodike, sa herë të gjykohet e nevojshme, por jo më rrallë se një herë në 6 muaj.
- 4.2. Palët do të caktojnë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret edhe në rrugë operationale të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, si dhe për shkëmbimin e informacionit lidhur me të.
- 4.3. Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore. Për rastet kur palët kërkojnë një informacion të rëndësishëm dhe urgjent për t'u përcjellë, komunikimi mund të bëhet dhe në mënyrë elektronike dhe verbale, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.

Neni 5

KOHËZGJATJA

- 1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë kohore 4 vjeçare.
- 2. Ndryshimet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.

3. Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim midis Palëve.
4. Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 60 ditë para me shkrim Palën tjetër.
5. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, nënshkruhet dhe protokollohet nga çdo palë dhe secila palë mban një kopje origjinale.
6. Kjo Marrëveshje është hapur dhe mund t'i bashkohet çdo organizatë jofitimprurëse, objekti i veprimtarisë të së cilës përputhet me këtë Marrëveshje dhe bie dakord me këto parime.

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

**KOMISIONIER
ROBERT GAJDA**



**ORGANIZATA
"SHËRBIMI LIGJOR FALAS
TIRANË (TLAS)**

**DREJTORE EKZEKUTIVE
RAIMONDA BOZO**

